

AKT THEMELEMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“PARTNERS PHARMA” SH.P.K

NENI 1

Në Tiranë, sot më datë 11.04.2019, në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 ‘Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare’ dhe Ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, themelohet shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar me emërtimin “**PARTNERS PHARMA**” SH.P.K.

NENI 2

Ortaku themelues i shoqërisë është :

1. **TIZJANA FASKO**, e bija e XHEVDET , e datëlindjes 24/07/1984, lindur në Fier me banim “Rezidenca Kodra e Diellit 2” Komuna e Parisit , identifikuar me nr ID I45724066L.

NENI 3

Emërtimi

Emërtimi i plotë i shoqërisë është Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “**PARTNERS PHARMA**” SH.P.K

NENI 4

Selia

Selia e Shoqërisë është Blloku Rezidencial “ Kodra e Diellit“ , AO/1, Tiranë.

Përveç ushtrimit të aktivitetit në nivel qendror, shoqëria ka të drejtë të hap degë dhe zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit. Selia e Shoqërisë mund të ndryshoj me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 5

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar, dhe do të fillojë nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit kur mbaron sipas parashikimeve të ligjit ose kur vendos Asambleja e Përgjithshme.

NENI 6

Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria “**PARTNERS PHARMA**” SH.P.K ka për objekt të veprimtarisë ekonomike:

1. Import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë në sektorin privat dhe atë publik, paketim, grumbullim, shpërndarje, përpunim të medikamente , materialeve, bimëve, lëndëve të para, artikujve gjysmë të përpunuar, aparaturave, pajisjeve laboratorike, produkteve të tjera farmaceutike me dhe pa recetë mjekësore, si dhe të gjitha llojeve të tjera të produkteve mjekësore, përgatesave dhe formulimeve të tjera për qëllime mjekësore, substancave dietike të përshtatura për përdorim mjekësor. Ushqimeve për fëmijë dhe të gjitha llojeve të aparateve dhe instrumenteve mjekësore etj;
2. Ofrim shërbimesh marketingu në promocion, distribucion, çështjet e regjimit, farmakovigjilencës etj. Ofrim shërbimesh dhe njerëzish të kualifikuar për të tretë në fushën e marketingut farmaceutik.
3. Kryerjen e studimeve të posacme të marketingut dhe të kërkimit të tregut në fushën farmaceutike dhe shëndetësore për të tretët sipas kërkesave të posacme. Prodhim, ambalazhim, paketim të medikamenteve dhe materialeve mjekësore.

4. Kërkime dhe botime shkencore, mjekësore nëpërmjet revistave, artikujve, broshurave, librave dhe CD-ve. Kurse informuese, edukuese dhe kualifikuese për mjekë dhe infermierë. Organizim seminaresh dhe kongresesh shkencore.
5. Pjesëmarrje në simpoziume dhe aktivitete ndërkombëtare për qëllimin e aktivitetit të shoqërisë si dhe në tendera brënda dhe jashtë shtetit. Shërbime në Urologji, Nefrologji, Lithotripsi, Kirurgji, ORL, Okulistikë, Neurologji, Ortopedi, Pediatri, Gjinekologji, Gastro intestinale, Pneumologji. Kirurgji Plastike dhe Kozmetikë, Fizioterapi, Rehabilitim, Spirometër, Gazi metër, Bronko sakopi, Studimi i gjumit etj.
6. Kooperimin dhe bashkëpunimin me Shoqëri Tregtare vendase apo të huaj, me qëllim ushtrimin dhe zgjerimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit dhe qëllimeve të veprimtarisë për të cilin ajo krijohet. Për kryerjen e aktiviteteve të mësipërme, për të cilin do të nevojitet leje përkatëse, shoqëria është e detyruar të pajiset paraprakisht me këtë leje nga organi kompetent. Përveç veprimtarive të parashikuara më lart , për të realizuar objektin e qëllimet e saj në veprimtarinë sipërmarrëse të shoqërisë, do të hyjë cdo lloj veprimtarie dhe aktiviteti tjetër industrial, tregtar, financiar, shërbimi qiradhënës apo dorëzanës që i vlerëson të dobishëm apo të nevojshëm për arritjen e qëllimeve të saj dhe që janë të lejuar nga legjislacioni shqipëtar.

NENI 7
Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 10,000 Lek (dhjetë mijë lek), i zotëruar plotësisht nga ortaku i vetëm:

Emri, Mbiemri	% që zotëron	Kuotat që zotëron	Shuma e kapitalit
Tizjana Fasko	100%	1 kuotë	10,000.00 lek

NENI 8

Administrator i shoqërisë do të jetë **Tizjana Fasko**

NENI 9

Drejtimi, organizimi dhe funksionimi i shoqërisë rregullohet sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar si dhe në bazë të Statutit dhe ketij Akti Themelimi.

NENI 10

Dispozita e fundit

Ky akt themelimi është perpiluar në disa kopje, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore.

ORTAKU THEMELUES

TIZJANA FASKO

Tizjana Fasko
